



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 tetor 2016
Nr. ref.:RK979/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI16/16

Parashtrues

Abdullah Cenkçiler

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së
Apelit të Kosovës, AA. nr. 229/2015, të 24 nëntorit 2015**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Abdullah Cenkçiler, shtetas i Republikës së Turqisë, i cili në Gjykatën Kushtetuese përfaqësohet nga z. Ibrahim Ibrahim, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 229/2015, i 24 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 229/2015, i 24 nëntorit 2015. Parashtruesi nuk përcakton se cilat të drejta kushtetuese i janë cenuar, por shpreh ankesën e tij lidhur me refuzimin e kërkesës për shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 janar 2016, nëpërmjet postës parashtruesi e dërgoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës me vendim caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 12 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
8. Më 12 prill 2016, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës edhe Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe kërkoi nga ajo që Gjykatës Kushtetuese t'i dorëzohet dosja e plotë e lëndës.
9. Më 15 prill 2016, Gjykata pranoi dosjen e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
10. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 26 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) - Komisionin për Shtetësi, duke kërkuar fitimin e të drejtës së shtetësisë mbi bazën e natyralizimit të pjesëtarit të diasporës, siç është paraparë me Ligjin për Shtetësinë e Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L-034).

12. Më 28 janar 2013, Komisioni për Shtetësi i MPB-së, me vendim refuzoi kërkesën e parashtruesit, me arsyetimin se ai nuk i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Shtetësinë.
13. Më 3 mars 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin për Ankesa të Çështjeve të Shtetësisë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Ankesa) të MPB-së, duke kundërshtar vendimin e shkallës së parë me të cilin iu refuzua kërkesa për shtetësi.
14. Më 22 nëntor 2013, Komisioni për Ankesa nxori Vendimin nr. 429, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimin e Komisionit të shkallës së parë.
15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet të autorizuarit të tij ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin për Çështje Administrative, duke kërkuar që në procedurën e konfliktit administrativ, Gjykata Themelore të anulojë Vendimin e MPB-së, nr. 429, të 22 nëntorit 2013, dhe që, pas administrimit të provave të paraqitura, parashtruesit të kërkesës, t'i njihet e drejta e shtetësisë së Republikës së Kosovës.
16. Më 2 shtator 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Çështjeve Administrative, nxori Aktgjykimin A. nr. 1676 /2013, me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
17. Gjykata Themelore në arsyetimin e Aktgjykimit të vet, ndër të tjera, kishte theksuar se *"me provat e administruara në shqyrtimin kryesor të dt. 02.09.2015, gjykata vëren se paditësi me asnjë provë të vetme nuk e ka provuar faktin se i njëjti mban lidhje familjare në Republikën e Kosovës; kërkesë kjo e përcaktuar nga neni 13.3 e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës nr. 03/L-034"*.
18. Më 12 tetor 2015, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë duke u thirrur në shkeljen themelore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
19. Më 24 nëntor 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin, AA. nr. 299/2015, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A. nr. 1676, të 2 shtatorit 2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se atij me vendimet e MPB-së dhe me aktgjykimet e gjykatave të rregullta, në mënyrë të padrejtë i është refuzuar e drejta për fitimin e shtetësisë së Kosovës, sepse ai ka paraqitur fakte të shumta me të cilat ka dëshmuar se i plotëson kushtet për shtetësinë e Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat dispozita kushtetuese i janë cenuar me vendimet Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

(...)

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Më tej, Gjykata merr në konsideratë nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

24. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcakton:

(1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(...)

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi te pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(d) parashtruesi nuk dëshmon ne mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

(...)

25. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata vëren që ai e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA. nr. 299/2015, të 24 nëntorit 2015, me të cilin Gjykata e Apelit vendosi lidhur me ankesën e tij kundër

Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me fitimin e të drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.

26. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës edhe pse sipas nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese e ka obligim të saktësojë kërkesën e tij, ai nuk e ka potencuar asnjë dispozitë të Kushtetutës ose të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila eventualisht mund t'i jetë cenuar me vendimet që i konteston, por nga përmbajtja e kërkesës dhe provave që ka paraqitur, duket se ai pretendon se ka pasur një gjykim jo të drejtë dhe të paanshëm të paraparë me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe veçanërisht duket se konteston rezultatin përfundimtar të gjykimit.
27. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar nga pikëpamja e kërkesës së parashtruesit të kërkesës dhe fakteve të prezantuara nga ai, Gjykata rikujton që e drejta e shtetësisë, që është themeli i kërkesës së parashtruesit, është paraparë me nenin 14, në kapitullin I të Dispozitave Themelore të Kushtetutës, i cili shprehimisht ka paraparë:

“Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me ligj”.

28. Shtetësia si një e drejtë të cilën e siguron Shteti për kërkuesin, në Republikën e Kosovës rregullohet me ligj duke përfshirë edhe format e fitimit apo humbjes së saj, dhe në këtë drejtim është e qartë se gjatë vendosjes së kërkesave lidhur me shtetësinë, organet kompetente administrative, ashtu sikur edhe gjykatat, zbatojnë dispozitat e ligjit i cili rregullon këtë materie juridike.
29. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se edhe MPB-ja gjatë vendosjes së kërkesës për shtetësi në dy shkallë në procedurë administrative edhe gjykatat e rregullta, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, përkatësisht, kanë zbatuar dispozitat në fuqi të Ligjit për Shtetësinë të Republikës së Kosovës.
30. Ligji për Shtetësinë e Republikës së Kosovës, përcakton qartë kriteret për fitimin e shtetësisë me natyralizim për pjesëtarët e diasporës. MPB dhe gjykatat e rregullta, e në veçanti Gjykata e Apelit, kishin arsyetuar se pse parashtruesi nuk i plotëson kushtet për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës me natyralizim. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit, rithekson që kushtet e parapara me paragrafët 13.2 dhe 13.3 të Ligjit për Shtetësinë e Republikës së Kosovës, sa i përket dëshmisë se parashtruesi i kërkesës mban lidhje familjare me Republikën e Kosovës, nuk ishin përmbushur.
31. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, në Aktgjykimin e vet kishte arsyetuar se: *“nga tërë kjo që u cek më lart dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe e plotë ... dhe nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të Ligjit për Konfliktet Administrative”.* Gjykata e Apelit, rithekson që *“paditësi me asnjë provë nuk ka provuar faktin se i njëjti mban lidhje familjare me Republikën e Kosovës, të cilat kriteret për fitimin e shtetësisë me natyralizim përcaktohen qartë në nenin 10 dhe 13 të Ligjit të Shtetësinë e Kosovës, nr. 03/L-34, i cili me nenin 13.3 përcakton se pjesëtari i diasporës së Republikës së Kosovës, konsiderohet edhe secili person i cili është*

pasardhës brenda një gjenerate i personit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe i cili dëshmon se mban lidhje familjare në Republikën e Kosovës. Ndërsa në paragrafin 13.4 përcaktohet se kriteret për caktimin e lidhjes së ngushtë familjare dhe ekonomike sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni caktohen nga organi kompetent me akt nënligjor, që do të thotë se nuk e ka përmbushin kriterin themelor ngase nga dëshmitë e ofruara, Komisioni nuk ka gjetur dëshmi se paditësi me asnjë provë të vetme nuk i vërteton pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike”.

32. Për më tepër, Gjykata më tej rithekson që pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të fokusuara në çështje të ligjshmërisë dhe jo mbi baza të shkeljeve të mundshme të dispozitave kushtetuese.
33. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet eventuale rreth konstatimit të gjendjes faktike ose të ligjit të zbatueshëm që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, në procesin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë) përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
34. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar, se njëri nga parimet themelore të gjykimit kushtetues, është ai i subsidiaritetit, i cili në kontekstin e veçantë të Gjykatës Kushtetuese, do të thotë që detyra për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta, u takon në radhë të parë autoriteteve administrative apo gjyqësore, dhe jo drejtpërsëdrejti Gjykatës Kushtetuese (Shih, *Scordino kundër Italisë*, nr. 1, [DHM], § 140).
35. Gjykata gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta ose organet e tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta ose organeve të tjera shtetërore është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
36. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër të tjera, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte mundësi të shumta për të shfaqur pretendimet e tij si në MPB ashtu edhe në Gjykatën Themelore dhe të Apelit, ku ishte aktiv në të gjitha fazat e procesit duke pasur mundësinë, që përmes përfaqësuesve të tij, të paraqes prova dhe të kundërshtoj vendimet e marra në instanca më të larta, andaj në asnjë mënyrë nuk mund të konstatohet se procesi në tërësinë e tij të ketë qenë arbitrar apo i padrejtë.
38. Gjykata më tej konsideron se procedurat para gjykatave të rregullta, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

39. Fakti i thjeshtë, se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të drejtave kushtetuese dhe sidomos të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005, shih gjithashtu rastin KI101/11, Aktvendimi për papranueshmëri i GJKK-së, i 12 janarit 2012, *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PPA nr. 4/2009*).
40. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se nga faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet se parashtruesi i kërkesës është subjekt i ndonjë shkeljeje të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e ndonjë të drejte kushtetuese apo të ndonjë të drejte të garantuar me KEDNJ.
41. Si rezultat, për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përmbushur kriteret e nenit 48 të Ligjit për saktësimin e kërkesës dhe nuk ka dëshmuar se kërkesa e tij bazohet në aspektin e shkeljeve kushtetuese të mbështetura në rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, prandaj kërkesa duhet refuzohet si e papranueshme si qartazi e papabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama - Hajrizi